

11. Kur lind e drejta dhe cila është mënyra për të zbritur TVSh-në ?

TVSh-ja, e zbritshme lind në kohën kur TVSh-ja, bëhet e ngarkueshme. Personi i tatueshëm mund të zbres nga obligimet e tij të TVSh-së, TVSh-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave dhe shërbimeve. Ai bën zbritjen duke zbritur nga shuma totale e TVSh-së, për një periudhë të caktuar tatimore, shumën totale të TVSh-së, së zbritshme. E drejta për të zbritur TVSh-në e zbritshme iu takon të gjithë personave të tatueshëm, të cilët ato blerje i përdorin apo synojnë t'i përdorin për furnizime të tatueshme dhe furnizime të liuruara me të drejtën e zbritjes së TVSh-së së zbritshme.

12. Deri kur keni të drejtë të njihni TVSh-në e zbritshme?

Nëse personi i tatueshëm nuk e zbrit TVSh-në e tij të zbritshme në periudhën tatimore kur ndodh ngjarja, ai mund ta zbres këtë shumë të TVSh-së së zbritshme në çdo kohë pas kësaj periudhe tatimore, mirëpo, jo më vonë se në periudhën e fundit tatimore të vitit kalendrik, pas vitit kur ka ndodhur ngjarja dhe për këtë zbritje me vonesë duhet të njoftojë Menaxherin e Zyrës Regionale.

**Rreth
e të hyrave të ATK-së vijnë
nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar**

50%

**“Pagesa e tatimit, siguron
qëndrueshmëri të
ekonomisë në vend!”**

Kontaktet e ATK-së

Nëse keni nevojë për më shumë informacione, ne ju inkurajojmë që të shqyrtoni ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse. Këto janë në dispozicion në faqen tonë të internetit www.atk-ks.org. Nëse nuk jeni në gjendje të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja, stafi i ATK-së është në dispozicion për të ju ndihmuar, prandaj drejtohu në zyret më të afërta të ATK-së:

Telefonat:

NUMRI DHE PAGESËS E TVSH

[1] Periudha tatimore:		
[3] Numri Fiskal:	NJTM : 038/200 346 41	
[4] Emri i personit të tatueshëm:		
[5] Adresa e personit:	Prishtina-1: 038/200-255-21	
[6] Emri i personit kontaktues:		[7] Numri i personit kontaktues:
[8] Vendi i vendosjes së të detyruesit rregullor:	Prishtina-2: 038/200-255-02	<input type="checkbox"/> Vetëm pagesë <input type="checkbox"/> Nëse nuk ka transaksione
[9] Furnizimet e përshuara për periudhën tatimore:	Prishtina-3: 038/200-255-17	
[10] Furnizimet e trajtuara si eksport:		
[11] Eksportet:		
[12] Shitjet e tatueshme me normë 16%:	Prizreni: 029/244-963	
[14] Nota debitoare e lëshuar dhe nota kreditore e marrë:	Peja: 039/432-812	
[16] Fatura e borhojve të leqit e pranuar dhe inkasimi i B.K.:		
[18] Rregullimet për të blerur TVSh-në për periudhën:		
[20] Blejtet që i nënshtrohen në zbritje:		
[23] Blejtet dhe importet pa TVSh:	Ferizaj: 0290/321-668	
[24] Blejtet dhe importet investive pa TVSh:		
[25] Blejtet dhe importet me TVSh jo të zbritshme:	Gjilani: 0280/326-967	
[26] Blejtet dhe importet investive me TVSh të zbritshme:		
[27] Importet e tatueshme:		
[29] Importet investive të tatueshme:		
[31] Blejtet e tatueshme me vendore:	Mitrovica: 028/590-667	
[33] Blejtet investive të tatueshme:		
[35] Nota debitoare e pranuar dhe nota kreditore e lëshuar:		
[37] Fatura e borhojve të leqit e lëshuar dhe pagesa e B.K.:	Gjakova: 0390/330-021	
[39] Rregullimet për të blerur TV.:		
[41] E drejta e kreditimit të TVSh-së në lidhje me ngarkesën e kundërt:		
[44] Teprica e TVSh-së e barcur:	Zyra Qëndrore: 038/200-250-17	
[45] Balanca kreditore e mbetur 45 - ((45+44)-22):0:		
[46] Kërkesa për rimbursim:		
[47] Kreditimi i tvsh-së për muajt:		
[48] TVSH që duhet të paguhet:		

Linja e përbashkët pa pagesë:

0800-80-800

Udhë-drejtimi: []

Udhë-drejtimi: []

Pjesa e bankës: [] Data: []

Nënskrimi dhe vula: [] Numri i logaritimit: **1000420070000373** Shuma e tatimit të paguar: []

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 17 & 200 250 07

Email: info@atk-ks.org; Web: www.atk-ks.org



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

**PYETJE - PËRGJIGJE
PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR**

Fletëpalosja me Pyetje dhe Përgjigje bazuar në Ligjin Nr. 03/L - 146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ka për qëllim Edukimin dhe Informimin e Tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, të cilat rrjedhin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar.

1. Çka është TVSh-ja?

TVSh-ja është tatim mbi konsumin (qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve). Llogaritet sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në faza të ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve dhe në fund i ngarkohet konsumatorit të fundit, kështu që si i tillë është tatim indirekt.

2. Kush është i obliguar të deklaroj për TVSh?

Secili person, i cili në mënyrë të pavarur zhvillon një aktivitet ekonomik në Kosovë, dhe kur qarkullimi total në 12 muajt e fundit tejkalon pragun prej 50,000 €, personat që dëshirojnë vullnetarisht të regjistrohen në TVSh dhe personat jo-rezident në Kosovë, pavarësisht pragu duhet të regjistrohen për certifikatë të TVSh-së, pra bëhen persona të tatueshëm dhe duhet të deklarojë atë në baza mujore.

3. Kush nuk është i obliguar, por mund të regjistrohet vullnetarisht për TVSh?

Personat e përfshirë në aktivitet ekonomik në mënyrë të pavarur që kanë qarkullim nën limitin e përcaktuar 50.000 €, nuk janë të obliguar të regjistrohen si deklarues të TVSh-së, mirëpo nëse ata dëshirojnë, mund të regjistrohen si deklarues vullnetar. Nga momenti kur ata bëhen persona të tatueshëm në mënyrë vullnetare, i marrin të drejtat dhe përgjegjësitë si çdo deklarues i TVSH-së.

4. Kur duhet ngarkuar TVSh-në?

Çdo person i tatueshëm obligohet që në furnizimet e bëra për konsumatorët e tij e që janë furnizime të tatueshme duhet të ngarkojë TVSh-në.

5. Cila është norma standarde tatimore e TVSh-së ?

16% Norma standarde e TVSh – së

6. Kur duhet të deklarohet TVSh-ja?

Deklarimi dhe pagesa e TVSh-së, bëhet më së voni deri në datën 20 të muajit pasues për muajin paraprak, p.sh. deklarata e muajit Korrik, bëhet më së voni deri me datën 20 Gusht, të po të njëjtit vit. Në rastet kur data 20 është ditë feste apo ditë vikendi, merret parasysh dita e ardhshme e punës.

7. Si dhe kur të regjistroheni për certifikatë të TVSh-së ?

Nëse qarkullimi total në 12 muajt e fundit tejkalon pragun prej 50,000 €, ju duhet të plotësoni formularin për t'u regjistruar për certifikatë të TVSh-së, i cili gjendet në ueb faqen e ATK-së, si dhe të paraqiteni në zyrën tuaj regjionale të ATK-së, dhe të sillni me vete një kopje të dokumenteve për regjistrim të biznesit, Certifikatën e Numrit Fiskal dhe dokumentin identifikues zyrtar me fotografi (pasaportë, letërnjoftim, etj.) Me këtë rast ATK-ja, do të shqyrtojë kërkesën tuaj dhe në momentin kur kërkesa juaj aprovohet, ATK-ja do t'ua lëshoj certifikatën e regjistrimit të TVSh-së, e cila përmban emrin, numrin tuaj fiskal dhe numrin unik të regjistrimit për TVSh, si dhe adresën ku zhvillonin aktivitetin e biznesit.

8. Çka nëse një person ngarkon TVSh-në, pa qenë i regjistruar për TVSh?

Nëse një person që nuk është i regjistruar për TVSh, e ngarkon atë në furnizimet e bëra, në bazë të legjislacionit tatimor do t'i nënshtrohet obligimit të TVSh-së mbi ato shitje, si dhe do të ketë ndëshkime administrative.

9. Cilat janë Procedurat për rimbursim të TVSh-së ?

Për kërkesat e rimbursimit të TVSh-së, duhet të zbatohen procedurat si në vijim:

- Të jetë në balancë kreditore në secilën periudhë tatimore për tremujorë;
- Në fund të secilit tremujor shuma e kreditimit të TVSh-së, duhet të tejkalojë vlerën prej 5,000€;
- Përveç kësaj rregulle për eksporte, mund të kërkohet rimbursimi pas çdo periudhe tatimore, mirëpo, kërkohet që transaksionet e eksportit të pasqyrojnë së paku 25% të transaksioneve totale me të drejtën e zbritjes së TVSh-së së zbritëshme;
- Të keni të deklaruar të gjitha deklaratat e TVSh-së, si dhe llojeve të tjera të tatimeve për të gjitha periudhat e kaluara. Për eksporte duhet të përbushen edhe të gjitha dispozitat e aplikueshme doganore;
- Përveq procedurave të lartëshenuara, kërkesë për rimbursim në periudha mujore mund të bëhen edhe nga kontraktuesit e KE dhe USAID-it, pavarësisht shumës së kreditimit.

10. Kur duhet të aplikohet për t'u pajisur me certifikatë për Eksport/Import ?

Nëse ju jeni të përfshirë në aktivitete ekonomike, nuk jeni të regjistruar për TVSh dhe dëshironi të zhvillonin aktivitete eksporti apo importi, jeni të obliguar që para se të filloni të zhvillonin këto aktivitete të njoftoni ATK-në, si dhe të kërkonin certifikatën për këtë aktivitet.

Ajo se çka ju duhet të bëni është, të plotësoni kërkesën për certifikatë eksporti dhe importi, të paraqiteni në zyrën tuaj regjionale të ATK-së, dhe të sillni me vete edhe një kopje të dokumenteve për regjistrim të biznesit, Certifikatën e Numrit Fiskal dhe dokumentin identifikues zyrtar me fotografi (pasaportë, letërnjoftim, etj.)

Me këtë rast ATK-ja, do të shqyrtojë kërkesën tuaj dhe në momentin kur kërkesa juaj aprovohet, ATK-ja do t'ua lëshoj certifikatën për eksport dhe import, e cila përmban emrin, numrin tuaj fiskal dhe numrin unik të certifikatës së eksportit dhe importit, si dhe adresën ku zhvillonin aktivitetin.